



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 461

Datë: 27.09.2023

Në bazë të nenit 7 paragrafi 7.3 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8 paragrafi 8.3 Statutin e Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e –VII- (shtatë) të rregullt të mbajtur me datë: 30.08.2023 merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INICIMIN E PROCEDURAVE PËR PLOTËSIMIN E STEMËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS

1.Miratohet formimi i Komisionit për inicimin e procedurave për plotësimin e stemës së Komunës së Malishevës.

2.Mbështetur në pikën 1 të këtij vendimi Komisioni do të jetë në këtë përbërje:

- 2.1.Valon Mazreku-Nisma Socialdemokrate-anëtar
- 2.2.Burim Paqarizi-PDK-anëtar
- 2.3.Driton Kastrati -LDK-anëtar
- 2.4.Arbnore Hoti-VV-anëtar
- 2.5. Eqrem Morina –AAK-anëtar
- 2.6.Valmir Gashi- përfaqësues nga zyra e kryetarit
- 2.7. Armend Mazreku- përfaqësues nga zyra e kryetarit

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Kryesuesit të Kuvendit.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivët të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 461

Datë: 27.09.2023

Në bazë të nenit 7 paragrafi 7.3 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8 paragrafi 8.3 Statutin e Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e –VII- (shtatë) të rregullt të mbajtur me datë: 30.08.2023 merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INICIMIN E PROCEDURAVE PËR PLOTËSIMIN E STEMËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS

1.Miratohet formimi i Komisionit për inicimin e procedurave për plotësimin e stemës së Komunës së Malishevës.

2.Mbështetur në pikën 1 të këtij vendimi Komisioni do të jetë në këtë përbërje:

- 2.1.Valon Mazreku-Nisma Socialdemokrate-anëtar
- 2.2.Burim Paqarizi-PDK-anëtar
- 2.3.Driton Kastrati -LDK-anëtar
- 2.4.Arbnore Hoti-VV-anëtar
- 2.5. Eqrem Morina –AAK-anëtar
- 2.6.Valmir Gashi- përfaqësues nga zyra e kryetarit
- 2.7. Armend Mazreku- përfaqësues nga zyra e kryetarit

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Kryesuesit të Kuvendit.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaci





REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

PRANIMARME

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO

No. Nr. Pr.

29. 08. 2023

01/149

Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë: 29/08/2023

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës
Kryesuesit z.Argjend Thaçi.

Datë: 29.08.2023

Kopje: Arkivit të komunës

Lënda: Kërkesë për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e stemës së Komunës së Malishevës.



Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Bazuar në Ligjin nr.03/L-0/40, Për Vetëqeverisjen Lokale, në Republikën e Kosovës, neni 7, Statutin e Komunës së Malishevës, neni 8 paragrafi 8 pika 3, para jush propozojë, iniciimin e procedurave ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e stemës së Komunës së Malishevës.

Në lidhje me këtë çështje, hapi parë propozojë që të formohet komisioni i cili do të kujdeset për zhvillimin e procedurave ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e stemës së Komunës së Malishevës. Komisioni do të bëjë thirrje publike për shprehje të interesit për persona fizik dhe juridik kompetent, që të ofrojnë propozimet e tyre në bazë të kriterëve të cilat do të përcaktohen nga Kuvendi i Komunës.

Pas përfundimit të gjitha çështjeve procedurale nga ky komision, si dhe pas konsultimeve publike, tri propozime do të parashtrohen para jush, dhe vetëm njëri do të votohet dhe përcaktohet me vendim, stema zyrtare e komunës së Malishevës.

Ky propozim ka rrjedhur si rezultat e kërkesave të vazhdueshme nga qytetarët e ndryshëm të komunës së Malishevës, por edhe për shkak se stema aktuale ka ngjashmëri të përafërta edhe me stema të komunave tjera për rreth ku edhe po ngjallen debate në rrethe të ndryshme me stemën e komunës së Malishevës.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Me respekt,